



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE  
INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK**

**PREVALENCA DHE FAKTORËT E RREZIKUT TË SËMUNDJES PULMONARE  
OBSTRUKTIVE KRONIKE  
(TIRANË, FIER, ELBASAN, KUKËS DHE KORÇË)**

Qëllimi i studimit ishte vlerësimi i prevalencës së sëmundjeve pulmonare obstruktive kronike (SPOK) dhe faktorëve të rrezikut që i atribuohen gjatë viteve 2021 dhe 2022, nga kartelizimi i kartelave nga klinika.

**Metodologjia** - Studimi u bazua në të dhënat e kartelave klinike për vitet 2021-2022 pranë Dispanserive të rretheve: Tiranë, Elbasan, Fier, Kukës dhe Korçë. Totali i kartelave që u studiuuan ishte 435 kartela të ndara; 160 kartela për 2021 dhe 275 kartela për 2022, ku peshën më të madhe e mbante Tirana në të dy vitet.

Informacioni nga kartelat përmbante: të dhëna demografike, faktorët e riskut, të dhënat klinike, ekzaminimet laboratorike, diagnoza, trajtimin dhe prognoza. Kohëzgjatja e studimit ishte 12 muaj, por realizimi përfshiu periudhën 7 mujore (Nëntor /2023- Qershor/2024). Elaborimi statistikor u realizua në programin SPSS.19.

### **Rezultate**

Rezultatet e përftuara treguan se duhanpirja, mungesa e aktivitetit fizik, dieta ushqimore, obeziteti (mbipesha, obezitet shkalla I, obezitet shkallaII) si edhe profesioni ishin ndër faktorët risk kryesorë të cilët kanë ndikuar në zhvillimin e problematikave pulmonare (SPOK) në 82.1% rasteve të studiuara dhe kryesisht gjinia mashkull dhe grup-mosha > 50 vjeç.

Rezultatet e përftuara mbi stadin e sëmundjes treguan se vlerat FEV<sub>1</sub> në përqindjen më të lartë gjenden tek grupmosha >50 vjec stadi i III (37.7%), i ndjekur nga stadi i IV ( 35.4%) dhe stadi i II (14.5%).